



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 169 Prot.

Tiranë, më datë 12.02.2021

VENDIM
Nr. 54, datë 12.02.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.02.2021,

VENDOSI:

1. Shtyrje vendimmarrje për projektin zhvillimor “Ndërtim i HEC Beun”, Bashkia Selenicë, me aplikues Devis Hasalami dhe raportin e vëzhgimit arkeologjik të realizuar nga subjekt i licencuar në arkeologji z. Taulant Rama;
 - Të plotësohet projekti me detajet teknike si infrastruktura ndihmëse, rrugët e aksesit, linja elektrike;
 - Të jepet informacion i plotë dhe i detajuar mbi gjetjet e konstatuara gjatë vëzhgimit si dhe potencialit arkeologjik përreth.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

